

Statuti i Shoqatës

Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma"

Organizatë, jofitimprurëse me antarësi

Shoqata e Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma", është krijuar në Tiranë me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit Nr.226 datë 13.10.1994. Në mbështetje të legjislacionit civil shqiptar, në Ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001, "Për Organizatat Jofitimprurëse", dhe në Ligjin nr. 8789, datë 07.05.2001, "Për Rregjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" vendosim hartimin e këtij Statuti, i miratuar me unanimitet nga Mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës Shqiptare të Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma", në mbledhjen e datës 28.10.2006 në Tiranë.

Forma e organizimit

Neni 1

Shoqata Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma" Tiranë, është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse me antarësi, e themeluar nga specialiste Otorinolaringollogë që punojnë në Republikën e Shqipërisë.

Në këto Shoqata mund të marrin pjesë edhe mjekë të tjerë Shqiptarë që punojnë dhe banojnë jashtë vendit.

Sigla dhe simboli i organizatës

Neni 2

Shoqata ka emrin "Shoqata Otorinolaringollogëve të Shqipërisë Besim Zyma".

Ajo ka vulën e saj të përcaktuar që në krijimin e saj ligjor. Sigla e Shoqatës do të jetë ORL-Besim Zyma.

Neni 3

Shoqata është person juridik që nga dita e regjistrimit të saj në Gjykatë.

Vula e Shoqatës Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma" Tiranë është e rrumbullakët me mbishkrimin: "Shoqata e Otorinolaringollogëve Shqiptarë".

Selia

Neni 4

Shoqata e ka selinë në Qendren Spitalore Universitare Tiranë, pranë Sherbimit Universitar të ORL Tiranë.

Themeluesit

Neni 5

Shoqata Otorinolaringollogëve të Shqipërisë "Besim Zyma", është krijuar në Tiranë me urdher të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit nr. 226 dt 13.04.1994.

Anetarët e Mbledhjes së Shoqatës Shqiptare Otorinolaringologeve të Shqipërisë "Besim Zyma" Tirane, janë: Narina Sulcebe; Besim Boci; Brikena Qirjazi; Dolorez Bardhyli; Suela Sallavaci; Tahsim Demi, Bledi Nini, Adnan Kelliçi, Pjerin Radovani, Ylli Sallavaci, Myslim Hysa, Agron Plevneshi, Vera Tavanxhi, Agron Strazimiri .
Ne Mbledhjen e Pare date 13.10.1994, Kryetar i Shoqatës u zgjodh Pjerin Rodovani dhe sekretar Agron Plevneshi.

Qëllimi i shoqatës Otorinolaringologeve të Shqipërisë "Besim Zyma" dhe fusha e veprimtarisë

Neni 6

Qëllimi i Shoqatës Otorinolaringologeve të Shqipërisë "Besim Zyma" Tirane, është rritja e nivelit Teknik dhe Shkencor të anetareve të saj, përhapja e përvijës së përparuar të kolegeve të huaja, duke rritur nivelin e punës klinike dhe diagnostike, nxitja e iniciativave për punë kerkimore shkencore, mbrojtja e të drejtave të anetareve të saj, forcimi i lidhjeve dhe bashkepunimin me shoqatat analoge të huaja.

Ndalimi i shpërndarjes së fitimeve

Neni 7

Fondet e realizuara nga veprimtaria e ligjshme e Shoqatës do të përdoren për zhvillimin dhe zgjerimin e objektit të veprimtarisë së Shoqatës. Çdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

Kohëzgjatja e veprimtarisë

Neni 8

Kohëzgjatja e Shoqatës është një periudhë kohe e pakufizuar, duke filluar nga data e miratimit të statutit. Kohëzgjatja mund të kufizohet nga një vendim i motivuar i Mbledhjes së Përgjithshme me pjesëmarrjen e 3/5 (tre të pestave) të anetareve, ashtu sikundër mund të zgjatet me të njëjtën mënyrë.

Organet drejtuese dhe kompetencat e tyre

Përbërja e tyre, rregullat për mbajtjen e mbledhjes, pjesëmarrja, procedura ,dhe ndryshimi i organeve drejtuese

Neni 9

Shoqata Otorinolaringologeve të Shqipërisë "Besim Zyma" do të organizohet e ndertohet në baze territori me nendëge dhe dege në qytete, krahina, zona e fshatra dhe e deri në qender.

Neni 10

Për drejtimin dhe udhëheqjen e veprimtarisë të Shoqatës së Otorinolaringologeve të Shqipërisë "Besim Zyma" do të funksionojnë organet e saj vendimmarrese dhe ekzekutive.

Neni 11

Organi me i larte vendim marres i Shoqates Otorinolaringollegeve te Shqiperise "Besim Zyma" do te jete Mbledhja e Pergjithshme e saj.
Mbledhja e Pergjithshme e Shoqates mblidhet nje here ne vit dhe funksionon kur jane te pranishem jo me pak se 1/2 e anetareve te saj.

Mbledhja e Pergjithshme e shoqates kryen keto funksione:

Miraton statutin e Shoqates dhe ndryshimet qe mund ti behen, aktin e themelimit, programin dhe vendos rregulla te brendshme per veprimtarine e te gjithe Shoqates;
Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarise se Shoqates;
Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit të Shoqatës;
Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës së Shoqatës;
Zgjedh kryesine e pergjithshme te Shoqates te perbere nga 7 anetare, kryetarin e kryesise, nenkryetarin dhe sekretarin e pergjithshem;
Mbledhja e Pergjithshme e Shoqates nuk ka te drejte te ndryshoje qellimin e veprimtarise se shoqates;
Vendos për likujdimin dhe emëron likujdatorët;
Krijon komitete të posacme, si edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj;
Cakton kuotizacionin e antarëve.

Neni 12

Vendimet e Mbledhjes se Pergjithshme merren me shumicen e thjeshte të antarëve.
Vendimet për ndryshimin e Statutit, të Aktit të Themelimit, për miratimin e rregulloreve të brendshme merren me shumicen e thjeshte te anetareve te shoqates.
Mbledhja e Pergjithshme thirret me propozim te Kryetarit, me vendim te kryesise, të paktën nje herë në vit. Njoftimet behen nepërmjet komunikimit me shkrim të drejtuar te gjitha degeve ne rrethe dhe zona te ndryshme. Njoftimi behet te pakten 15 (pesëmbdhjetë) ditë përpara datës së caktuar për mbledhje. Ky komunikim duhet të përmbajë ditën ku do të mbahet mbledhja si edhe rendin e ditës që do të ketë mbledhja. Mbledhja e Shoqates mblidhet edhe në rast të ndonjë kërkesë të motivuar , nga të paktën 3/5 (tre te pestat) e anëtarëve të Mbledhjes se Pergjithshme.
Mbledhja e Pergjithshme mund te mblidhet jo vetëm në selinë e saj qendrore në Tiranë, por edhe jashtë kësaj selie në çdo vend te caktuar nga Kryesia.

Organet ekzekutive te Shoqates

Neni 13

Organet ekzekutive te Shoqates jane:

- a. Kryesia e Pergjithshme e Shoqates qe perbehet nga Kryetari, Nenkryetari dhe Sekretari i pergjithshem dhe nga 4 anetare.

Organi më i lartë ekzekutiv i Shoqatës është Kryesia e Shoqates. Kryesia zgjidhet me një mandat 3 vjeçar me të drejtë rimandatimi. Kryesia ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit. Kryesia drejton të gjithë veprimtarinë e Shoqates midis dy Mbledhjeve të Pergjithshme. Ajo ekzekuton vendimet e marra nga Mbledhja e Pergjithshme, pergatit dhe miraton programin vjetor të punes, projekt buxhetin dhe ja paraqet për miratim Mbledhjes së Pergjithshme të anetareve të kësaj Shoqate. Kryesia merr vendime që kanë të bëjnë me zbatimin e detyrave të lena nga Mbledhja e Pergjithshme e Anetareve.

Neni 14

Kryetari gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka këto kompetenca:

- Realizon veprimtarinë e përditshme dhe ekzekuton programet e vendosura nga Mbledhja e Pergjithshme e anetareve të Shoqates dhe Kryesia e Shoqates.
- Drejton veprimtarinë e Shoqatës, në bazë të Statutit perfaqeson Shoqaten në marrëdhënie me të tretet, banken, Gjykatën etj
- Administron fondet për veprimtarinë e përditshme dhe raporton në Kryesinë e Shoqates.
- Hyn në marrëdhënie me organizma të tjera vendase dhe të huaja.

Nenkryetari i Shoqates ndihmon Kryetarin e Shoqates në zbatimin e detyrave të përditshme.

Sekretari i Shoqates bashkëpunon me Kryetarin dhe Nenkryetarin e Shoqates, administron dokumentacionin e shoqates.

Në mbledhjen e përgjithshme të anetareve të shoqates datë 28-10-2006, u zgjodh kryesia e shoqates e përbërë nga 7 anetare: Narin Sulcebe, Besim Boci, Brikena Qirjazi, Dolores Bardhyli, Suela Sallavaci, Tahsim Demi, Bledi Nini.

Kryetar u zgjodh NARIN Sulcebe, nenkryetar Besim Boci dhe sekretar Brikena Qirjazi.

Organet drejtuese të degëve të Shoqates në rrethe dhe zona

Neni 15

Cdo degë në baze rrethi ose zone drejtohet nga një kryesi që përbehet nga 3 deri në 5 vete. Kjo kryesi zgjidhet me votim të fshehte për tre vjet nga mbledhja e përgjithshme e Anetareve të Shoqates, banorë të rrethit ose zones që formojnë degen përkatëse.

Kryesia zgjedh një kryetar dhe një Sekretar.

Kryesia e degës merr vendime që i shërbejnë zbatimit të vendimeve të marra nga Mbledhja e Pergjithshme e shoqates. Ajo zbaton detyrat dhe porositë e kryesise të shoqates.

Kryesia e degës është e detyruar të zbatojë në veprimtarinë e vet qëllimin, programin dhe statutin e shoqates.

Kryesia e degës miraton kërkesat për pranimin e anetareve të rinj në shoqate.

Keto vendime për pranimë të anetaresise ja paraqet për miratim në mbledhjen me të afert të Mbledhjes së Pergjithshme të shoqates.

Kryetari dhe Sekretari i deges se shoqates ndjekin dhe zbatojne veprimtarine e perditshme te deges se tyre. Ata administrojne fonde qe mund te kene ne dispozicion te vena nga kryesia e shoqates.

Antarësimi në Shoqatë të drejtat dhe detyrat **Neni 16**

Antarësimi në Shoqatë bëhet me bazë vullnetare. Pranimi i programit të Shoqates se Otorinolaringollogëve te Shqiperise "Besim Zyma" dhe statuti përbën kushtin per antarësim në Shoqatë. Mund te behen anetarë të Shoqatës personat fizike, organizatat apo entet private apo publike që, duke njohur dhe pranuar Statutin e Shoqatës, kanë bërë kërkesë antaresimi dhe që antarësimi i tyre miratohet nga Mbledhja e Pergjithshme e Shoqates. Ata duhet kane paguar kuoten vjetore të anëtaresimit te përcaktuar nga Mbledhja e Pergjithshme e Shoqatës.

E drejta per te dhene doreheqjen i garantohet cdo anetari te shoqates por me kusht qe ai te paraqese nje kerkese se paku nje muaj para largimit ne kryesine e deges se shoqates. Kryesia e deges, vendimin per miratimin per doreheqjen e anetarit ja paraqet Mbledhjes se Pergjithshme te shoqates.

Anëtarët që nuk kanë derdhur kuotën e anëtaresimit brenda 4 (kater) muajve nga fillimi i vitit, konsiderohen sikur kanë dhënë dorëheqjen prej saj.

Neni 17

Të gjithë anetarët kanë të drejta të barabarta në Shoqatë. Antarët përfaqësohen në Mbledhjen e Pergjithshme te degeve te shoqates dhe kanë të drejtën e një vote të vetme. Cdo antarë i Shoqatës i ushtron të drejtat e tij si në mënyrë individuale ashtu edhe në mënyrë kolektive.

E drejta e antaresise ne shoqate nuk mund te tjetersohet dhe as te kalohet me ane trashegimie.

Anetarët qe kane dhene doreheqjen ose jane perjashtuar nga shoqata nuk kane te drejte ne kapitalin apo pasurine themelore te shoqates.

Neni 18

Çdo anetar ka te drejte te shfaqe mendimet e tij, te diskutoje ne mbledhje, te kerkoje llogari per harxhimin e fondeve, te kundërshtojë ne Gjykatën Kompetente vendimet e shoqates qe vijne ne kundërshtim me ligjin dhe statutin brenda nje muaji nga dita qe ka marre njoftimin per ate vendim.

Gjithashtu çdo anetar ka per detyre te zbatoje me rigorozitet dispozitat ligjin ne fuqi dhe statutin e shoqates, si dhe te derdhe kuotat nje here ne vit ne daten e caktuar.

Rregullat për bashkimin dhe ndarjen e Shoqates

Neni 19

Shoqata me vendim të Kryesise te saj dhe me miratimin e dhënë nga Mbledhja e Pergjithshme, për arsye të lehtësirave që mund të krijohen nga bashkëpunimi, gjithmonë

në të mirë të arritjes së objektivit të Shoqatës, mund të bashkohet me organizata të tjera jofitimprurëse me antarësi.

Shoqata konsiderohet e shpërndarë me rregjistrimin e subjektit të ri.

Përfaqësimi ligjor

Neni 20

Kryetari drejton dhe përfaqëson ligjërisht Shoqatën në raport me të tretët.

Në mungesë të Kryetarit për një periudhë prej 1 (një) muaji, detyrën e tij e kryen nenkryetari i shoqates me autorizim të Kryetarit ose të kryesise.

Në rastet kur përfaqësimi kryhet nga një anëtar i Shoqatës me autorizim, veprimet e tij miratohen në mbledhjen e Përgjithshme më të parë.

Rregullat për likuidimin dhe destinimin e pasurisë pas mbarimit të organizatës

Neni 21

Vendosja në likuidim e Shoqatës përcaktohet nga Mbledhja e Përgjithshme e Shoqatës, e cila kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit dhe mbylljen e Shoqatës. Likujduesi ose likujdatorët emerohen me vendim të Mbledhjes së Përgjithshme. Vendimi për emërimin e likujduesit ose likujdatorëve merret me 3/5 e votave të antarëve të pranishëm.

Me emërimin e likujdatorit ose të likujdatorëve pushojnë funksionet e kryetarit.

Neni 22

Likujduesi ose likujdatorët, brenda 2 (dy) muajve nga data e emërimit, thërrasin Mbledhjen e Përgjithshme të shoqates, ku paraqesin raportin mbi gjendjen e financiare të Shoqatës, aktivin dhe pasivin e Shoqatës, para se të fillojë operacioni i likuidimit.

Neni 23

Likujduesi ose likujdatorët përfaqësojnë Shoqatën dhe kanë të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj.

Janë të autorizuar të paguajnë të gjithë kreditorët dhe më pas të vlerësojnë pasurinë e mbetur dhe kujdesen, që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga Statuti.

Neni 24

Pasuria e Shoqatës pas shpërndarjes së saj do t'u kalojë në mënyrë proporcionale të gjitha degeve të shoqates në rrethe dhe zona, të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Te ardhurat e Shoqates

Neni 25

Të ardhurat e Shoqatës do të sigurohen nga:

Kuotizacionet e antarëve të shoqatës, të cilat caktohen për vitin e parë të hyrjes në fuqi të statutit të ri të Shoqatës nga Kryesia dhe miratohen në Mbledhjen e Pergjithshme të parë të rradhës të Shoqatës dhe për vitet pasardhëse nga Mbledhja e Pergjithshme e Shoqatës.

- Të ardhura dhe financime nga donatorët, vendas ose të huaj.
- Buxheti i Shoqatës përbëhet edhe nga dhuratat, ndihmat, programet e financuara nga organizmat ndërkombëtare, fondacionet e huaja e kombëtare, bordet lokale rajonale kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Të ardhurat e siguruar nga vetë veprimtaria e Shoqatës.

Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.

I gjithë dokumentacioni i të ardhurave të shoqatës dhe i shpenzimeve perpilohen sipas ligjeve në fuqi.

Per drejtimin financiar të shoqatës, kryesia e shoqatës emeron financiere dhe kontrolluese, të cilët për veprimtarinë e tyre raportojnë në kryesinë e shoqatës.

Dispozita tranzitore
Përbërja e organeve të para drejtuese

Neni 26

Mbledhja e Pergjithshme e shoqatës dt. 28.10.2006, me vota unanime miratoi këtë statut dhe të gjithë anëtarët e nënshkruan.

1. Narina Sulcebe
2. Besim Boci
3. Brikena Qirjazi
4. Dolorez Bardhyli
5. Suela Sallavaci
6. Tasim Demi
7. Bledi Nini.
8. Adnan Kelliçi
9. Pjerin Radovani
10. Ylli Sallavaci
11. Vera Tavanxhi
12. Agron Strazimiri

